

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7924
E mërkurë, 6 nëntor 2024
Çmimi 0.50 €

Amerikanët
zgjedhin mes Harrisit
dhe Trumpit. FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KATËR VJET PADREJTËSI

FAQE 6-7



Katër vjet më parë Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi u patën dorëzuar vullnetarisht në Gjykatën Speciale për t'u ballafaquar ballëhapur në betejën e fundit në mbrojtje të luftës së drejtë të UÇK-së. Ata

janë duke u mbajtur në paraburgim në Hagë pavarësisht se shpeshherë kanë kërkuar të mbrohen në liri. Gjykimi ndaj tyre ka filluar në prill të vitit 2023 dhe deri më tani janë dëgjuar mbi 100 dëshmitarë. Shumica prej tyre kanë dëshmuar në

seanca private dhe për këtë arsye është kritikuar shumë puna e Speciales. Në katërvjetorin e arrestimit, ka pasur reagime të shumta mbështetëse për katërshen e UÇK-së, por edhe kritika të ashpra për punën e Speciales

**KRASNIQI DHE HAMZA
VIZITOJNË FAMILJEN E
THAÇIT DHE VESELIT:
ATA DO TË DALIN
FAQEBARDHË EDHE
NGA KJO BETEJË** F. 3



**KURTI VIZITON
FAMILJEN E
REXHEP
SELIMIT: 10-tshi
YNË I LIRISË, NA
MUNGON!** F. 4



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

AKTUALE



**OSMANI PRANON RAPORTIN PËR
KOSOVËN, THOTË SE VENDI YNË
MBETET I PËRKUSHTUAR
PËR INTEGRIM NË BE** F. 3

**TETË VJET NGA VDEKJA
E ASTRIT DEHARIT, KURTI ME
BASHKËPARTIAKË BËJNË
HOMAZHE TE VARRI I TIJ** F. 6

**NJË HOTEL NË PRISHTINË VODHI
21 050 EURO RRYMË,
KEDS-I E ZË NË VEPËR** F. 6

EKONOMI



**BIE INDEKSI I PËRGJITHSHËM I
PRODHIMEVE BUJQËSORE** F. 8

**ÇFARË DO TË THOTË HAPJA
E KUFIRIT ENERGJETIK NË MES
TË KOSOVËS DHE SERBISË?** F. 8

SPORT



**KONFERENCA PËR SPORTIN: KA
NEVOJË PËR MË SHUMË PUNË QË TË
PARANDALOEN FENOMENET NEGATIVE
NË AKTIVITETET SPORTIVE** F. 10

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Amerikanët zgjedhin mes Harrisit dhe Trumpit



WASHINGTON, 5 NËNTOR - Qytetarët amerikanë më 5 nëntor kanë votuar për zgjedhjet historike presidenciale, për të cilat votuesit janë të ndarë në nivel vendi, por edhe në shtatë shtete kryesore që pritet ta përcaktojnë rezultatin mes ish-presidentit republikan Donald Trump dhe nënpresidentës demokratike Kamala Harris.

Zgjedhjet amerikane pritet të kenë implikime të mëdha për luftën e Rusisë kundër Ukrainës, luftërat në Lindjen e Mesme dhe për çështje të tjera botërore, sikurse janë ndryshimet klimatike.

Qendrat e votimit u hapën në orën 05:00 (11:00 sipas kohës lokale në Kosovë) në disa shtete lindore dhe votimet do të vazhdojnë në mbarë vendin, përfshirë në Alaskë dhe Havai, deri në orët e mbrëmjes në shtetet që gjenden në perëndim të Shteteve të Bashkuara.

Rezultati i kësaj gare të ngushtë nuk pritet të dihet për ditë të tëra në disa shtete sikurse Pensilvani, ku numërimi i votave me postë është proces më i ngadalshëm. Dalja në zgjedhje pritet të jetë e lartë, sipas Byrosë së Regjistrimit. "Kjo mund të jetë gara më e ngushtë në historinë tonë. Çdo votë ka rëndësi", tha Harris gjatë përmblyljes së fushatës gjatë një

tubimi në Filadelfi.

Mbrëmjen e 4 nëntorit zyrtarët federalë zgjedhorë paralajmëruan se me një garë kaq të ngushtë, Rusia dhe Irani po shtojnë fushatat e tyre të ndikimit me synimin që të ndjellin përçarje në mesin e votuesve amerikanë me qëllim që të nxitet dhunë ndaj zyrtarëve zgjedhorë, pas një fushate të ashpër.

Trumpi po garon për herë të tretë, pasi humbi zgjedhjet më 2020 ndaj presidentit aktual Joe Biden, i cili u tërhoq nga gara presidenciale në korrik pasi sondazhet treguan se ai kishte pasur një paraqitje të dobët gjatë debatit me Trumpin dhe kishte shqetësime lidhur me moshën e tij.

Zëvendësimi i tij nga radhët e demokratëve, Harris, nëse zgjidhet do të bëhet gruaja e parë presidente e ShBA-së dhe personi i parë me prejardhje nga Azia Jugore. Trumpi do të bëhet presidenti i dytë në histori që do të fitonte mandat presidencial në mënyrë jo të njëpasnjëshme. I vetmi president që e kishte bërë këtë ishte Grover Cleveland në fund të shekullit 19.

Harris, 60-vjeçare, e ka paraqitur veten si ndryshim brezash nga Bideni, 81 vjeç, dhe Trumpi 78 vjeç. Ajo ka shprehur

mbështetjen e saj për të drejtën e abortit pas vendimit të vitit 2022 të Gjykatës Supreme që i dha fund të drejtës kushtetuese për abort. Ajo, po ashtu, e ka cilësuar Trumpin si rrezik për demokracinë dhe ka përmendur rolin e tij në sulmin e 6 janarit ndaj ndërtesës së Kongresit amerikan dhe refuzimit që të pranohet humbjen nga Bideni më 2020.

Trumpi ka përdorur thirrjet e tij populiste për ta përçarur mesazhin se gjatë mandatit të dytë ai do të bëjë më shumë për ta përmirësuar ekonominë, për ta frenuar valën e migrantëve që hyjnë në ShBA dhe ka thënë se do të ishte më i ashpër kundër kundërshtarëve të shtetit, sikurse Kina.

Rezultati i zgjedhjeve amerikane mund ta prekë Ukrainën më shumë se çdo vend tjetër i huaj. Kandidatët kanë dy qëndrime shumë të ndryshme sa i përket mbështetjes për Ukrainën, mbrojtja e së cilës kundër trupave pushtuese ruse varet shumë nga mbështetja ushtarake, financiare dhe diplomatike që i jep ShBA-ja. Harris ka thënë se ajo do ta vazhdojë politikën e Bidenit për ta ndihmuar Ukrainën, duke shprehur dëshirën që ta shohë të mposhtur Rusinë.

Trumpi ka vënë në pikëpyetje mbështetjen amerikane për Ukrainën, duke thënë se Evropa duhet ta bartë pjesën më të madhe të barrës së mbështetjes të Ukrainës kundër pushtimit të nisur nga Rusia, po ashtu e ka vënë në dyshim të ardhmen e NATO-s.

Dy kandidatët presidencialë kanë tentuar që në ditët e fundit të fushatës të fitojnë sa më shumë mbështetje dhe secili prej tyre e kanë portretizuar veten si vendimtar për të ardhmen e Amerikës.

Më 4 nëntor Harris qëndroi në Pensilvani, ku 19 votat zgjedhore janë të rëndësishme në mesin e shteteve kryesore që pritet ta përcaktojnë rezultatin e Kolegjit Zgjedhor.

"A jeni gati për ta bërë këtë?", u tha Harris mbështetësve të saj në Skranton, duke qëndruar para një mesazhi të madh ku shkruhej "Voto për Lirinë".

Trumpi e nisi ditën e 4 nëntorit me një fushatë në Karolinën e Veriut, para se të merrte pjesë në dy tubime në Pensilvani dhe më pas e përmbylli fushatën në Miçigan. "Nëse fitojmë Pensilvaninë, do t'i fitojmë zgjedhjet", tha Trumpi.

Këto tri shtete së bashku me Viskonsinin, Xhorxhian, Arizonën dhe Nevadën janë

shtetet që pritet të përcaktojnë se kush do të jetë presidenti i ardhshëm i ShBA-së.

Sipas sistemit amerikan, nuk është vota popullore ajo që përcakton se kush do të jetë president, por Kolegji Zgjedhor prej 538 anëtarësh, në të cilin secili shtet ka një numër të përcaktuar paraprakisht të zgjedhësve, që është numër i barabartë me numrin e përfaqësuesve që shtetet kanë në Kongres.

Çdo shtet, me përjashtim të Nebraskës dhe Mejnin, ua japin votat në Kolegjin Zgjedhor kandidatit që ka më së shumti vota popullore në shtetin përkatës.

Nëse Harris dhe Trumpi dëshirojnë ta arrijnë shumicën prej 270 votash në Kolegjin Zgjedhor, Dhoma e re e Përfaqësuesve në janar do ta zgjedhë presidentin dhe Senati i ri, po ashtu, do ta zgjedhë nënpresidentin.

Më shumë se 77 milionë votues veçse kanë votuar, por zgjedhjet e 5 nëntorit do të jenë test kritik se cili kandidat ka bërë punë më të mirë për t'i bindur mbështetësit e tyre që të votojnë.

Harris veçse ka votuar përmes postës. Trumpi planifikon të votojë në Florida në ditën e zgjedhjeve.

Koalicioni AAK - Nisma dhe të tjerët premtajn që paga mesatare të jetë 1 000 euro

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, së bashku me partnerët e koalicionit, Fatmir Limaj, Artan Nimani dhe Abdullah Klinaku, janë pajtuar për programin zgjedhor 2025-2029, që ndër shtyllat kryesore të tij ka

anëtarësimin në NATO, zhvillimin ekonomik, konsolidimin demokratik e institucional, paga mesatare që nuk do të jenë nën 1 000 euro e pensione në nivel të pagës minimale prej 500 eurosh, si dhe familjen si shtyllë të shoqërisë. "Po

ashtu, e diskutuam edhe listën e kandidatëve për deputetë, përbërja e së cilës garanton cilësi e gjithëpërfshirje dhe një ekip kompetent për t'i realizuar synimet tona programore dhe elektorale", ka thënë Haradinaj.



Osmani pranon raportin për Kosovën, thotë se vendi ynë mbetet i përkushtuar për integrim në BE



EPOKA
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të martën në takim shefin e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, ambasadorin Aivo Orav, i cili i ka dorëzuar "Raportin për Kosovën 2024" nga Komisioni Evropian. Sipas njoftimit të Presidencës, raporti i sivjetshëm vlerëson pozitivisht përparimin e Kosovës

në disa fusha, si dhe identifikon sfida në disa fusha të tjera. Me këtë rast, presidentja Osmani theksoi se Republika e Kosovës mbetet e palëkundur për integrimin në BE. Në këtë frymë, presidentja Osmani u shpreh se zgjerimi i BE-së do të kontribuojë jo vetëm në prosperitetin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Kosovës, por edhe në paqen dhe sigurinë afatgjatë në rajon dhe më gjerë.

Më tej, Osmani deklaroi se Kosova vazhdon të jetë në ballë të reformave dhe është plotësisht e harmonizuar me politikën e jashtme dhe të sigurisë së BE-së, një element që është theksuar edhe në raport. Në takim u diskutuan edhe gjetjet e raportit, të cilat nënvizojnë nevojën për adresimin e mospërputhjeve në fusha të caktuara. Presidentja theksoi se këto gjetjet

duhet të trajtohen me prioritet me qëllim të avancimit të vazhdueshëm të demokracisë dhe sundimit të ligjit. Presidentja Osmani ka potencuar se është shumë me rëndësi që raporti ka ritheksuar nevojën e përsëritjes së procesit të zgjedhjes së Kryeprokurorit, duke respektuar parimet e transparencës dhe meritokracisë. Siç njofton Presidencën, raporti i sivjetshëm veçon përpjekjet e

pandalshme të presidentes Vjosa Osmani në agjendën për Gratë, Paqen dhe Sigurinë (WPS). Aty theksohet vëmendja e lartë politike nga ana e presidentes për barazinë gjinore, të drejtat e grave dhe viktimave të dhunës seksuale, njëkohësisht organizimi i Forumit Ndërkombëtar për Gratë, Paqen dhe Sigurinë i cili kishte mbledhur mbi 1 mijë pjesëmarrës nga mbi 40 vende të botës.

ZKA dhe NDI diskutojnë për forcimin e bashkëpunimit institucional

Prishtinë, 5 nëntor - Auditorja e Përgjithshme e Kosovës, Vlora Spanca, e shoqëruar nga zëvendësauditori i përgjithshëm, Beza Halilaj dhe ndihmësauditorja e përgjithshme, Myrvete Gashi-Morina, kanë pritur të martën në takim menaxherin e Lartë të Programit në Institutin

Kombëtar Demokratik (NDI), Artan Murati dhe zyrtaren e Programit, Merisa Abdullahu. Spanca foli rreth misionit dhe mandatit të ZKA-së, duke theksuar rolin e saj në sigurimin e transparencës, llogaridhënies dhe përdorimit efektiv të burimeve publike në Kosovë, përfshirë edhe iniciativat e

ndryshme që ZKA ndërmerr. Ndërsa Murati i njoftoi të pranishmit mbi punën e organizatës, veçanërisht për mbështetjen e qeverisjes demokratike dhe forcimin e institucioneve, me theks në projektet e vazhdueshme të NDI-së, përfshirë punën me Kuvendin e Kosovës.





KATËR VJET PADREJTËSI

Katër vjet më parë Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi u patën dorëzuar vullnetarisht në Gjykatën Speciale për t'u ballafaquar ballëhapur në betejën e fundit në mbrojtje të luftës së drejtë të UÇK-së. Ata janë duke u mbajtur në paraburgim në Hagë pavarësisht se shpeshherë kanë kërkuar të mbroheshin në liri. Gjykimi ndaj tyre ka filluar në prill të vitit 2023 dhe deri më tani janë dëgjuar mbi 100 dëshmitarë. Shumica prej tyre kanë dëshmuar në seanca private dhe për këtë arsye është kritikuar shumë puna e Speciales. Në katërvjetorin e arrestimit, ka pasur reagime të shumta mbështetëse për katërshen e UÇK-së, por edhe kritika të ashpra për punën e Speciales

**EPOKA
ERE****Lirim GECI**

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Të martën janë bërë katër vjet nga arrestimi i Hashim Thaçit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit nga Gjykata Speciale. Një ditë pas tyre, më 4 nëntor të vitit 2020, ishte arrestuar Jakup Krasniqi. Derisa Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi po mbahen në paraburgim në Hagë, kritikën ndaj Gjykatës Speciale janë shtuar. Shkelja e shumë procedurave në proces dhe stërzgjatja e procesit gjyqësor kanë bërë që të lëkundet besimi në Gjykatën Speciale, e cila ishte formuar nga Kuvendi i Kosovës. Përfaqësuesit e organizatave të dala nga lufta e UÇK-së dhe zyrtarët e partive politike kanë vlerësuar se ish-krerëve të UÇK-së po u bëhen padrejtësi të

mëdha në Hagë.

Ushtruesi i detyrës së kryetarit të OVL-UÇK-së, Faton Klinaku, ka reaguar me rastin e katërvjetorit të arrestimit të ish-krerëve të UÇK-së në Hagë. Ai ka thënë se Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit po u bëhet një padrejtësi e madhe. Klinaku ka vlerësuar se Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi janë heronj për popullin e Kosovës. "Sot u bënë katër vjet nga padrejtësia që po bëhet ndaj shokëve tanë, padrejtësi e cila po i bëhet edhe Kosovës dhe luftës së saj çlirimtare të udhëhequr nga UÇK-ja. Për popullin, të gjithë bashkëlufetarët që gjenden prapa grilave atje janë heronj", ka shkruar Klinaku. Ndërsa shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, ka shkruar në "Facebook" se para katër vitesh Hashim

Thaçi ishte nisur edhe në një rrugë për në Hagë për t'ia hequr një perde të padrejtësisë dhe UÇK-së. "Sado që na irriton padrejtësia, kjo rrugë e presidentit Thaçi nuk do të jetë kurrë në një drejtim. Për të dhe shokët e tij, dielli do të lindë përsëri", ka shkruar Tahiri. Kritika më të ashpra ndaj Gjykatës Speciale ka shprehur anëtari i Kryesisë së PDK-së, Adri Nurellari. Ai ka bërë me dije se asnjë gjykatë nuk mund ta ndryshojë historinë e luftës çlirimtare të Kosovës. Sipas tij, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit po u bëhen padrejtësi të mëdha në këtë proces gjyqësor. "Asnjë gjykatë, qoftë edhe ajo Speciale në Hagë, nuk mund ta përmbysë këtë të vërtetë. Përprjekjet për ta ndryshuar historinë janë një padrejtësi shtesë ndaj një populli që ka vuajtur padrejtësi të panumërta. Drejtësia nuk mund të manipulohet për ta barazuar viktimën me xhelatin. E vërteta është një dhe e pandryshueshme: shqiptarët nuk ishin agresorë, por viktima të një gjenocidi, dhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte mburoja e popullit të saj", ka shkruar Nurellari. Më tutje, ish-eporri i lartë i UÇK-së, Daut Haradinaj, është shprehur i bindur se Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi do të shpallen të pafajshëm. "Sot bëhen katër vjet nga dorëheqja si pasojë e ngritjes së akuzave nga Gjykata Speciale në Hagë

ndaj ish-presidentit Thaçi, ish-kryeparlamentarëve Jakup Krasniqi dhe Kadri Veseli, si dhe ish-deputetit Rexhep Selimi. Të gjithë këta luftëtarë për liri e paqe, të rreshtuar në vetëmbrojtje të popullit të Kosovës nga makineria fashiste e Serbisë së Millosheviqit. Akuzat ndaj të gjithë shqiptarëve që sot ndodhen në Hagë janë akuza të pavërteta, të fabrikuara, të pabaza dhe të ngarkuara politikisht. Jam i bindur se drejtësia do të triumfojë, ashtu siç triumfoi e drejta për të qenë të lirë", ka shkruar Haradinaj në "Facebook". Për arrestimin e katërshes së UÇK-së kanë reaguar Vlora Çitaku, Adem Grabovci, Ferat Shala etj. Ata kanë shprehur bindjen se bashkëlufetarët dhe bashkëpunëtorët e tyre do të triumfojnë në Speciale. Madje ata kanë kujtuar edhe thënien e Thaçit, i cili, para se të shkonte në Hagë, kishte deklaruar: "Dielli do të lindë përsëri". Derisa liderët e UÇK-së ishin arrestuar më 4 dhe 5 nëntor të vitit 2020, Gjykata Speciale e kishte nisur procesin gjyqësor në prill të vitit 2023. Që nga atëherë kanë dëshmuar mbi 100 dëshmitarë. Shumica prej tyre kanë dëshmuar në seanca private, të cilët publiku i Kosovës nuk kishte mundësi t'i dëgjonte e shihte çfarë po ndodhte. Një gjë e tillë kishte ndodhur me kërkesën e Prokurorisë dhe me vendimin e Gjykatës për sigurinë e dëshmitarëve. Pas urdhrorit nga gjyqtarët, Prokuroria

e Specializuar në Hagë është e obliguar ta përfundojë rastin e saj më së largu në prill të vitit 2025. Si rezultat, vazhdimisht Prokuroria po largon dëshmitarë, në mënyrë që ky afat i vendosur të arrihet. Avokatët e Hashim Thaçit kanë ngritur alarmin se në mesin e këtyre largimeve janë larguar dy dëshmitarë me rëndësi jetike për të vërtetën në fund të procesit. Pas përfundimit të rastit të prokurorisë, do të jetë radha e avokatëve të krerëve të UÇK-së që t'i paraqesin dëshmitarët e tyre. Ligjërisht, pas paraqitjes së rastit nga prokuroria, avokatët kanë të drejtë ta kërkojnë hedhjen e aktakuzës. Avokatët e krerëve të UÇK-së kanë njoftuar se synojnë ta shfrytëzojnë këtë mundësi, megjithatë afati është i shkurtër. "Do të kërkojmë të paktën 1 muaj kohë për ta bërë kërkesën tonë", ka thënë avokati i Jakup Krasniqit. Kurse avokati i Hashim Thaçit, Luka Misetiq, ka bërë me dije se do t'i duhen gjashtë javë për t'u përgatitur për ta paraqitur rastin e mbrojtjes. Ai ka theksuar se nuk planifikon të thërrasë më shumë se 10 dëshmitarë. Siç thonë juristët e njohës të Speciales, procesi në Hagë mund të përmbillet me një vendim në shkallën e parë, në fundin e vitit 2025 ose më së largu në fillimin e vitit 2026. Kujtojmë se Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi janë deklaruar të

Krasniqi dhe Hamza vizitojnë familjen e Thaçit dhe Veselit: Ata do të dalin faqebardhë edhe nga kjo betejë

Kryetari i PDK-së tha se Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi dhe të gjithë shokët e tyre do të dalin faqebardhë edhe nga kjo betejë e fundit për të vërtetën e lavdisë së luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. “Pa dyshim, dielli do të lindë përsëri”, shkroi ai

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi dhe kandidati për kryeministër, Bedri Hamza, të martën, me rastin e 4-vjetorit të arrestimit nga Dhomat e Specializuara në Hagë të ish-presidentit Hashim Thaçi dhe kryetarit Kadri Veseli, kanë vizituar familjet e dy ish-liderëve të PDK-së. “Sot, kur po bëhen 4 vite nga arrestimi i tyre nga

Dhomat e Specializuara në Hagë, në dy takime të përzemërta që pata me Lumen dhe Endritin, gruan dhe të birin e presidentit Thaçi, si dhe me Violetën, bashkëshorten e kryetarit Veseli - rikthyem në kujtesë momentet më krenare me ta si familjarë e bashkëpunëtorë, fjalët me peshë e rrugën që na e trasuan drejt fitoreve e sukseseve”, ka shkruar lideri i PDK-së.



Krasniqi ka thënë se Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli u lindën për t'i shërbyer atdheut. “Fati i Kosovës, u bë fati i tyre. Rrugëtimi i tyre ndër dekada, si çlirimtarë, shtetformues dhe liderë vizionarë - është një histori e jashtëzakonshme dashurie dhe kontributi për Kosovën. Thënë më mirë, ata dhe shokët e tyre janë vetë historia”, ka shkruar Krasniqi në “Facebook”. Kryetari i PDK-së tha se Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi dhe të gjithë shokët e tyre do të dalin faqebardhë edhe nga kjo betejë e fundit për të vërtetën e lavdisë së luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. “Pa dyshim, dielli do të

lindë përsëri”, shkroi ai. Ndërkaq Bedri Hamza ka theksuar se nëntorët në vitet e fundit nuk janë si më parë. “Presidenti Thaçi, kryetari Veseli dhe bashkëluftëtarët e tyre, po i mungojnë Kosovës, familjeve dhe gjithë neve. Sot i vizituar familjet e tyre, të cilat janë plot me shpresë, siç jemi edhe ne, që ky proces i stërzgatur së shpejti do të marrë fund me konfirmimin e pastërtisë së luftës së UÇK-së dhe rikthimin e tyre në mesin tonë. Sot, më shumë se kurrë, ne duhet të qëndrojmë të bashkuar për ta, për Kosovën dhe të ardhmen e popullit tonë”, ka shkruar Hamza në “Facebook”.

Kurti viziton familjen e Rexhep Selimit: 10-tshi ynë i lirisë, na mungon!

Prishtinë, 5 nëntor - Lëvizja Vetëvendosje ka njoftuar për vizitën e liderit, kryeministrit Albin Kurti, te familja e Rexhep Selimit, me rastin e katërvjetorit të arrestimit të tij nga Gjykata Speciale. “Bashkëshortja e tij dhe deputetja Shqipe Mehmeti-Selimi, përforcoi edhe një herë bindjen tonë të pathyeshme: lufta e UÇK-së ishte e drejtë dhe dinjitoze. Ne do të vazhdojmë ta

kundërshtojmë gjykatën e padrejtë, gjykimin e padrejtë, ashtu siç kemi bërë gjithmonë. Rexhep Selimi, 10-tshi ynë i lirisë, na mungon! Rexhep Selimi tash e katër vjet është duke u mbajtur padrejtësisht në burgun e Hagës. Një figurë e çmuar që i shërbeu vendit si ish-komandant i UÇK-së dhe më pas si deputet që nga hyrja jonë në institucione në vitin 2010, si anëtar i Kryesisë

dhe si Shef i Grupit Parlamentar të Lëvizjes, Rexhep Selimi ka qenë gjithmonë simbol i vendosmërisë dhe triumfit. Si Lëvizje, si anëtarësi e si aktivistë, jemi të patundur në mbështetjen për Rexhepin dhe shpresojmë që ai të kthehet sa më parë te ne, te vendi që aq shumë e desh dhe për të cilin kontribuoi shumë dhe pa kursyer asgjë”, thuhet në njoftimin e LV-së.



pafajshëm qysh në paraqitjet e para në Gjykatë Speciale. Po ashtu, ata kanë kërkuar të mbroheshin në liri, por që katër vjet nuk u është mundur një gjë e tillë.

KMDLNj: Gjykimi ndaj liderëve të UÇK-së në Hagë, maratonë e një krimi juridik

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka reaguar ashpër ndaj procesit gjyqësor në Hagë,

duke e cilësuar si “maratonë të një krimi juridik”. Sipas KMDLNj-së, procesi po zgjatet në mënyrë të padrejtë dhe po zhvillohet me shkelje të rënda të të drejtave të njeriut.

KMDLNj-ja ka theksuar se parimi i prezumimit të pafajësisë është shkelur, ndërsa shumica e seancave janë mbajtur të mbyllura, duke përjashtuar publikun në 63 % të rasteve. “Proces i stërzgatur dhe paragykses për parimin e prezumimit të pafajësisë nga kupola e Gjykatës Speciale dhe

Zyrës së Prokurorit të Specializuar përmes deklaratave publike dhe intervistave. Proces në të cilin brutalisht shkellet parimi i publicitetit duke e përjashtuar publikun në më shumë se 63 për qind të seancave gjyqësore përmes seancave të mbyllura”, është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

Këshilli, gjithashtu, ka kritikuar edhe redaktimin e materialeve të mbrojtjes dhe përkthimin e vonuar në shqip, duke e quajtur këtë një pengesë të qëllimshme

për mbrojtjen efektive. KMDLNj-ja ka ngre shqetësime edhe për keqtrajtimin e të paraburgosurve në aspektin shëndetësor dhe social, duke përmendur raste ku të arrestuarit lejojnë vizita familjare vetëm pas vdekjes së të afërmeve të tyre. “Familjarët dhe avokatët e ekipit mbrojtës fillimisht janë penguar duke ua mohuar vizat afatgjatë. Shërbimet shëndetësore janë ofruar me vonësë dhe vetëm pasi janë dënuar me dënim afatgjatë. Ushqimi është jashtë kontekstit

tradicional dhe nevojave shëndetësore. Brutalisht po keqpërdoren vizitat humanitare pasi, në jo pak raste, pengjet e Hagës lejohen t'i vizitohen anëtarët e familjeve të tyre vetëm pasi ata të vdesin, që nënkupton se ata po vizitohen varre dhe jo më të dashurit e tyre”, është thënë në reagimin e KMDLNj-së. Këshilli që drejtohet nga Behxhet Shala ka bërë thirrje për monitorim ndërkombëtar të kushteve në të cilat mbahen të akuzuarit dhe kërkon një gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Arrestohet një zyrtar doganor dhe një zyrtar policor, dyshohen për marrje ryshfeti

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Task Forca e përbashkët Doganë - Polici, në zbatim të masave për parandalim dhe luftimin e paligjshmërisë dhe kontrabandës, kanë identifikuar një rast korrupsioni, ku të dyshuar ishin një zyrtar doganor dhe një zyrtar policor. Menjëherë pas dyshimit se zyrtarët në koordinim merrnin pagesa të jashtëligjshme, u njoftua Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) dhe njësitë relevante të Doganës, të cilët, në koordinim, realizuan

arrestimin e një zyrtari doganor dhe një zyrtari policor për përfshirje në aktivitete të kundërligjshme. Të dy zyrtarët u ndaluan nën dyshimin se kishin bashkëpunuar për marrje të parave nga drejtues të kamionëve për t'i lehtësuar kalimet nëpër pikën kufitare Hani i Elezit. Dy të arrestuarit do të përballen me procedurat ligjore në përputhje me dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe të njëjtëve me aktvendim të prokurorit u është caktuar masa e ndalimit

për 48 orë. Ky aksion është rezultat i përkushtimit të vazhdueshëm të institucioneve për ta luftuar korrupsionin dhe për ta mbrojtur integritetin e sistemit doganor dhe policor të Kosovës. Task Forca Doganë - Polici mbetet e angazhuar në mënyrë të vendosur për ta çrrënjësuar çdo formë të sjelljes së paligjshme dhe për ta siguruar mbrojtjen e interesave të qytetarëve dhe të ekonomisë së vendit. Dogana e Kosovës dhe IPK inkurajojnë qytetarët të



raportojnë çfarëdo akti të paligjshëm përmes mekanizmave të dedikuar të raportimit për ta rritur më tej transparencën dhe sigurinë në shërbimet tona.

Kosova nga perspektiva e ShBA-së dhe BE-së, interesat dhe synimet strategjike



Shkruan:
Prof. Dr. Fejzulla
BERISHA

Parashtrohet pyetja: "Pse ShBA dhe BE mbështesin integrimin ndërkombëtar të Kosovës?" është mjaft domethënëse, pasi nënvizon përkushtimin e këtyre aktorëve të rëndësishëm ndërkombëtarë për përfshirjen e Kosovës në skenën ndërkombëtare. Mbështetja e ShBA-së dhe BE-së për Kosovën rrjedh nga disa faktorë kryesorë:

Pas luftës së Kosovës në vitet 1998-1999, Ballkani u përball me tensione të vazhdueshme etnike dhe politike, veçanërisht ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. ShBA dhe BE kanë ndërhyrë shpesh për të ndërmjetësuar dialogun Kosovë-Serbi, një proces që synon njohjen reciproke dhe pajtimin.

Një Kosovë sovranë dhe e integruar në strukturat ndërkombëtare, sipas

Perëndimit, do të ndihmonte në stabilizimin e marrëdhënieve në Ballkan dhe në reduktimin e rrezikut të konflikteve të reja.

Një shembull i këtij ndërmjetësimi është Marrëveshja e Brukselit (2013), që synonte krijimin e një rruge të përbashkët për integrimin e të dy vendeve në BE, duke e konsideruar integrimin e Kosovës në strukturat ndërkombëtare si një pjesë kyçe për sigurinë dhe stabilitetin rajonal.

Rusia dhe Kina, që kanë mbështetur Serbinë në mosnjohjen e Kosovës, kanë ndikuar në rajon përmes mbështetjes ekonomike dhe politike. Rusia ka përdorur të drejtën e vetos në Këshillin e Sigurimit të OKB-së për të bllokuar njohjen ndërkombëtare të Kosovës, duke synuar ruajtjen e ndikimit të saj në Ballkan dhe pengimin e zgjerimit të influencës perëndimore.

Për t'iu kundërvënë këtij ndikimi, BE dhe ShBA kanë organizuar takime të nivelit të lartë, si Dialogu i Berlinit (2019), ku përfaqësues të Kosovës dhe Serbisë u ftuan të bisedonin për një marrëveshje të qëndrueshme që do të çonte



drejt sovranizimit të Kosovës dhe integritet të saj në BE dhe NATO, struktura ku ndikimi rus është i kufizuar. Kosova ka përfituar gjithashtu nga programet e mbështetura nga BE dhe ShBA për forcimin e sundimit të ligjit dhe ndërtimin e institucioneve demokratike. Për shembull, Misioni i BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) ka punuar për përmirësimin e sistemit gjyqësor dhe luftën kundër korrupsionit, që janë të rëndësishme për një sovranitet të qëndrueshëm.

Ndërkohë, BE-ja ka ndihmuar edhe në monitorimin e zgjedhjeve në Kosovë, duke mbështetur zhvillimin e

zgjedhjeve të lira e të ndershme dhe përforcuar stabilitetin demokratik të vendit.

Ekonomikisht, Kosova është pjesë e CEFTA-s, një marrëveshje që lejon lirinë e tregtisë mes vendeve të Evropës Juglindore.

Me mbështetjen e ShBA-së dhe BE-së, Kosova ka krijuar lidhje ekonomike me fqinjët e saj, duke rritur eksportet dhe zhvillimin ekonomik. Investimet perëndimore në infrastrukturë dhe energjetikë, të mbështetura nga ShBA dhe BE, kanë kontribuar në përmirësimin e kushteve ekonomike në vend dhe e kanë integruar më mirë atë në tregjet evropiane, një faktor kyç për

stabilitetin dhe integrimin ndërkombëtar.

NATO, gjithashtu, ka pasur një mision të gjatë paqeruajtës në Kosovë që nga përfundimi i luftës. KFOR-i garanton një mjedis të sigurt në Kosovë, duke mbështetur paqen dhe stabilitetin, dhe duke sinjalizuar Serbisë dhe vendeve të tjera se Kosova është e mbrojtur dhe se nuk do të tolerohen kthimet në situata konflikti.

Procesi i dialogut Kosovë-Serbi është prioritet për ShBA dhe BE, duke u parë si një mekanizëm për të siguruar stabilitetin dhe sovranitetin e Kosovës, si dhe për t'i dhënë fund konflikteve të vjetra që pengojnë sigurinë rajonale.

Në përfundim, ShBA dhe BE e shohin integrimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare si një investim në paqen, stabilitetin dhe prosperitetin afatgjatë të Ballkanit. Me ndërhyrjet e tyre diplomatike, ekonomike dhe të sigurisë, ata synojnë të ndihmojnë në ndërtimin e një Kosove të fuqishme dhe të integruar, që do të kontribuojë në një Evropë më të sigurt dhe më të bashkuar, duke shërbyer si themel për zhvillimin demokratik të rajonit të Ballkanit dhe Evropës në tërësi.

Një hotel në Prishtinë vodhi 21 050 euro rrymë, KEDS-i e zë në vepër

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Gjatë këtyre ditëve ekipet e kontrollit të KEDS-it zunë në vepër pronarin e një hoteli në Prishtinë duke e vjedhur energjinë elektrike. Ai, duke anashkaluar njehsorin elektrik, pajisjet hoteliere po i shfrytëzonte në të zezën dhe pa paguar fare për energjinë e shpenzuar.

Kur KEDS-i bëri kalkulimet, doli që ai vodhi një sasi të madhe të energjisë elektrike, që në vlera monetare arrin në 21 050.80 euro.

Ai detyrohet t'ia kthejë KEDS-it këtë shumë të parave në kuadër të Rikthimit të Humbjeve - si masë e parë ligjore ndaj tij. "Kjo nuk mbaron me kaq! Vjedhja e

energjisë elektrike është vepër penale, dhe ky konsumator do të ballafaqohet me gjykatat kompetente të Republikës së Kosovës. Kodi Penal e cilëson keqpërdorimin e energjisë si vjedhje të shërbimeve, për të cilën, sipas nenit 314, dënimi mund të jetë deri në tri vjet burgim", ka njoftuar KEDS-i.



Tetë vjet nga vdekja e Astrit Deharit, Kurti me bashkëpartiakë bëjnë homazhe te varri i tij

EPOKA
ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Në tetëvjetorin e vdekjes së Astrit Deharit, kryeministri Albin Kurti bashkë me kryetarin e Kuvendit, Glauk Konjufca, nënkryetaren e Kuvendit, Saranda Bogujevci, me anëtarë të Kryesisë së Lëvizjes, ministra, deputetë dhe aktivistë, fillimisht vizituan familjen Dehari e më pas bashkë me ta dhe shoqëri të gjerë bënë homazhe duke vendosur lule të freskëta te varri i Astrit Deharit. Kryeministri Kurti në prononcimin e tij për medie tha se vrasja e Astrit Deharit vazhdon të jetë e rëndë për shkak të drejtësisë që mungon. Ai tha se në këto tetë vjet kishim katër prokurorë që dolën në pension pa e kryer punën dhe tash e kemi prokurorin e pestë ndaj të cilit, po ashtu, shprehim interesimin, gatishmërinë dhe vullnetin ta ndihmojmë me krejt çfarë mundën si Lëvizje e si Qeveri e Kosovës, për të sjellë drejtësinë e munguar. "Sot u mbushën 8 vjet pa Astritin. Na mungon shumë. Na merr malli për ditë. Zemërimi e pikëllimi nuk na hiqet, dhe vit pas viti mungon drejtësia, mungon zbardhja e këtij rasti, i

cili ishte goditje tejet e rëndë për studentët, për Lëvizjen Vetëvendosje! dhe për mbarë rininë shqiptare. E kjo goditje tejet e rëndë vazhdon edhe pas 8 vjetëve në një formë tjetër nëpërmjet drejtësisë që mungon. Në këto 8 vjet katër prokurorë e kishin rastin e mbytyes në burgun e Prizrenit të Astrit Deharit, por që të katërtit ata dolën në pension pa e kryer punën. Tash është prokurori i pestë, i cili e ka marrë rastin dhe si Lëvizje Vetëvendosje!, si qeveri e Republikës, jemi shumë të interesuar, fort të gatshëm, gjithnjë të vullnetshëm që ta ndihmojmë me krejt çfarë mundemi e dimë prokurorinë e shtetit për të sjellë drejtësi për Astrit Deharin, familjen e tij, Lëvizjen e tij, popullin e tij. Por këtë ndihmë dhe mbështetje që ne duam e duhet ta japim nuk është e tillë që mund ta zëvendësojë punën e prokurorisë andaj besojmë e shpresojmë që ky prokurori i pestë që e ka marrë rastin tani do të punojë dhe do të kontribuojë në ndriçimin e këtij rasti dhe në sjelljen e drejtësisë në kontrast me ata para tij. Ne shokët e shoqet e Astritit mbajmë në zemër Astritin, ashtu qysh ai



gjithë jetën e tij e pati në zemër Republikën e Kosovës, kombin shqiptarë, dhe Lëvizjen Vetëvendosje!. Lavdi Astritit, dhe i lehtë i qoftë dheu i Kosovës", ka thënë Kurti. Babai i Arbënor dhe Astrit Deharit, shkrimtari, deputeti Avni Dehari, falënderoi pjesëmarrësit në homazhe dhe ndau urimin që ky rast të mos zvarritet më tutje dhe të zgjidhet

sa më parë. Ai theksoi se nëse gjyqësia dështon në këtë rast e në raste të ngjashme, atëherë tregon që Kosova nuk e meriton një gjyqësi të tillë. "Humbja e jetës së Astritit në burgun e Prizrenit ka 8 vjet që po manipulohet e keqtrajtohet nga gjyqësia e Kosovës. 8 vjet një njeri që ka humbur jetën në një institucion të Kosovës - të mos zbardhet e vërteta për të, flet për

ata që kanë bërë krimin ndaj Astritit dhe drejtësisë, flet për ata që edhe sot e kësaj dite mundohen t'i fshehin gjurmët e tyre. Urimi im do të ishte që jo të zbardhet e vërteta vetëm për Astritin, por nëse nuk zbardhet ky rast, edhe raste të tjera, flet shumë se gjyqësia e Kosovës nuk është në nivel, dhe Kosova nuk meriton të ketë një gjyqësi të tillë", tha deputeti Dehari.

Nënshkruhet memorandum i mirëkuptimit në mes të Kosovës dhe Luksemburgut

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Kosovës, Besnik Bislimi, mbajti konferencë të përbashkët për medie me zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Punëve të Jashtme, Shkëmbimit Tregtar dhe Bashkëpunimit e Veprimit Humanitar të Luksemburgut, Xavier Bettel. Para fjalëve respektive të palëve, u nënshkrua një memorandum i mirëkuptimit në mes të Kosovës dhe Luksemburgut. Nga ana e Kosovës memorandum i nënshkrua nga ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, ndërsa nga pala e Luksemburgut u nënshkrua nga



zëvendëskryeministri Bettel, në kapacitetin e tij edhe si ministër i Punëve të Jashtme dhe Shkëmbimit Tregtar. Memorandum i mirëkuptimit përbëhet nga dy fonde për mbështetjen e sektorit privat:

Fondeve të LuxAid Challenge dhe LuxAid Demonstration. Këto dy fonde synojnë ta mbështesin sektorin privat vendor për të promovuar inovacionin dhe për ta përshpejtuar arritjen e Objektivave të Zhvillimit të

Qëndrueshëm. Në adresimin e tij, zëvendëskryeministri Bislimi tha se: "Në katër vitet e fundit dy shtetet tona gjenden edhe më pranë njëra-tjetrës. Shkëmbimet mes nesh dhe ndërlihdja mes kompanive të dy vendeve tona janë të rëndësishme për avancimin edhe më tej të raporteve në mes të Kosovës dhe Luksemburgut. Te Kosova ju do të gjeni përherë një shtet partner, për të lëvizur bashkë drejt një ekonomie në rritje. Të kujdesemi që ta shfrytëzojmë plotësisht potencialin që ofrohet nga ky bashkëpunim drejt ndërtimit të një të ardhme të qëndrueshme për qytetarët tanë". E zëvendëskryeministri Bettel

vlerësoi miqësinë dhe partneritetin me Kosovën duke thënë se kjo është një miqësi me besim reciprok. Ai shtoi se do të vizitojë përgjatë qëndrimit në Kosovë projektet e përbashkëta të zbatuara dhe investimet e Luksemburgut në vendin tonë të cilat prekin fusha të ndryshme. Zëvendëskryeministri Bettel tha se Kosova që e sheh sot nuk është e njëjta me atë të 10 viteve më parë dhe shprehu se është i sigurt se Kosova e pas 10 viteve do të jetë edhe më zhvilluar dhe përparimtare. "Për të qenë pjesë e BE-së është shpesh një maratonë dhe jo një sprint, por tash jam i impresionuar nga sprinti i qeverisë suaj", përfundoi zëvendëskryeministri Bettel.

ASK-ja u jep mirënjohje AKI-së dhe Policisë

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka dhënë mirënjohje për kontributin e dhënë nga institucionet për siguri dhe siguri kibernetike gjatë procesit të regjistrimit REKOS 2024. U. d. kryeshefi i Agjencisë së Statistikave të Kosovës, Avni Kastrati, ka thënë se ASK-ja ka

falënderuar institucionet e sigurisë për një kontribut të jashtëzakonshëm në fazat e rëndësishme të regjistrimit duke e bërë atë një proces më të sigurt për pjesëmarrësit. Bazuar në koordinimin e aktiviteteve në mes të ASK-së dhe institucioneve të tjera, në këtë rast atyre të sigurisë, procesi i regjistrimit në

aspektin kombëtar dhe atë ndërkombëtar është treguar i suksesshëm dhe kjo është meritë e të gjitha institucioneve. Nga ana e institucioneve është thënë se ky lloj i bashkëpunimit është i domosdoshëm dhe duhet pasur përkushtim të njëjtë në çdo proces tjetër siç ka pasur gjatë REKOS.



Çfarë do të thotë hapja e kufirit energjetik në mes të Kosovës dhe Serbisë?



PRISHTINË, 5 NËNTOR - Linjat ndërlidhëse energjetike në kufirin ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, të cilat menaxhohen nga Operatorët e Sistemit të Transmisionit të të dyja vendeve, janë fizikisht funksionale dhe aktive, por për arritjen e qëllimeve komerciale është e rëndësishme që ato të përdoren. Kështu thanë për "Radion Evropa e Lirë" nga Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT), duke theksuar, po ashtu, se shpërndarja e kapaciteteve neto transmetuese në kufirin ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do t'u ofronte palëve më shumë mundësi për tregtimin e energjisë elektrike. Përndryshe, linja ndërlidhëse paraqet një lloj kufiri energjetik, përkatësisht lidh sistemet energjetike të dy ose më shumë vendeve, mundëson shkëmbimin e energjisë elektrike dhe rrit stabilitetin e sistemit, si dhe sigurinë e furnizimit me energji elektrike.

Zëvendëskryeministri i Kosovës dhe kryenegociatori në bisedimet me Serbinë, Besnik Bislimi, tha më 24 tetor se është bërë përparim në zbatimin e

Marrëveshjes për Energjinë dhe se Beogradi është pajtuar për t'i lëshuar në funksion linjat ndërlidhëse deri në fund të nëntorit.

"Radio Evropa e Lirë" e kontaktoi kabinetin e Bislimit për më shumë hollësi lidhur me këtë çështje, por nuk mori përgjigje.

Pala serbe nuk e përmendi atë dhe nuk iu përgjigj pyetjeve të REL-it rreth saj.

I dërguari i posaçëm i BE-së në bisedimet Kosovë - Serbi, Mirosllav Lajčak, tha më 29 tetor se disa ditë pas takimit me Bislimin dhe kryenegociatorin serb Petar Petković, se nuk ka pasur përparim sa i përket zbatimit të Marrëveshjes për rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve mes dy vendeve, por shtoi se është optimist kur bëhet fjalë për çështje të tjera. "Ka pasur përparim në disa çështje të tjera të rëndësishme të cilat do t'i monitorojmë në javët në vazhdim", shkroi Lajčaku në llogarinë e tij në "Facebook". Ai nuk specifikoi saktësisht se për çfarë përparimi bëhet fjalë, por tha se është takuar me drejtorin e Sekretariatit të Komunitetit të

Energjisë, me të cilin ka biseduar për bashkëpunimin energjetik në Ballkanin Perëndimor.

Në anën tjetër, KOSTT-i shpjegoi për "REL"-in se Kosova aktualisht ka tri linja ndërlidhëse plotësisht funksionale: në kufi me Malin e Zi, Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut.

Në raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të Kosovës thuhet se Elektrorrjeti i Serbisë ka bllokuar linjat ndërlidhëse për përdorim komercial edhe në vitin 2023 dhe se rezultat i këtij bllokimi ka qenë mungesa e kapacitetit transmetues ndërkufitar. "Mungesa e kapaciteteve transmetuese ndërkufitare, si rezultat i bllokimit të linjave interkonektive për operim komercial nga ana e Serbisë, vazhdon të shkaktojë vështirësi serioze për tregtarët, siç është pengimi i tregtisë së energjisë në këtë kufi, duke reflektuar kështu me rritjen e çmimit të kapaciteteve ndërkufitare në kufijtë e tjerë dhe çmimin e importit të energjisë për Kosovën dhe për Evropën Juglindore", u tha në raportin e publikuar në mars.

KOSTT: Marrëveshja operative me Elektro-ekonominë e Serbisë (EMS) mundëson bashkëpunim më të madh

Ndër hapat e fundit drejt zbatimit të plotë të Marrëveshjes për Energjinë është pikërisht lëshimi në funksion të linjave ndërlidhëse. "Hap i ardhshëm mund të jetë nënshkrimi i Marrëveshjes Operative ndërmjet KOSTT-it dhe EMS-së - me të gjitha anekset teknike - e cila mundëson bashkëpunim më të madh në mes të dy operatorëve të sistemit të transmisionit", tha KOSTT-i për "Radion Evropa e Lirë".

Deri në publikimin e këtij artikulli, EMS-ja nuk iu përgjigj pyetjes së "REL"-it se a planifikon të nënshkruajë një marrëveshje të tillë me KOSTT-in.

Në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve, Kosova dhe Serbia arritën marrëveshje për energjinë në vitin 2013 dhe 2015, ndërsa në qershor të vitit 2022 dy palët miratuan Udhërrëfyesin për zbatimin e këtyre

marrëveshjeve.

Atëkohë BE-ja, e cila ndërmjetëson dialogun, tha se marrëveshjet për energjinë të viteve 2013 dhe 2015 "janë zbatuar vetëm pjesërisht".

Ndërkohë, pas nënshkrimit të Udhërrëfyesit, u funksionalizua plotësisht kompania "Elektrosever", e cila i furnizon me rrymë komonat me shumicë serbe në veri të Kosovës dhe mbledh faturat që filloi t'u ua dërgojë konsumatorëve qysh në fillim të këtij viti. Deri atëherë, banorët e Mitrovicës së Veriut, Leposaviqit, Zveçanit dhe Zubin Potokut nuk e paguan rrymën për rreth 25 vjet.

Kompania "Elektrosever" është në pronësi të Elektro-ekonomisë së Serbisë, por në Kosovë është e regjistruar sipas ligjeve të Kosovës.

Në bazë të Udhërrëfyesit për zbatimin e marrëveshjeve energjetike, KOSTT-i ofroi qasje edhe në nënstacionin e Vallaçit, i cili e siguron shumicën e energjisë elektrike për qytetarët në veri të Kosovës. Ai, gjithashtu, e furnizon me energji elektrike hidrocentralin në liqenin e Ujmanit.

Vallaçi është një nga nënstacionet e para të ndërtuara në Kosovë në sistemin e transmisionit. Ai është i lidhur me pesë linja të tensionit të lartë 110 KV: Trepça, Skenderaj, Ujmani, Ilirida (afër Mitrovicës) dhe Palaj (afër Prishtinës), si dhe me stacionin Novi Pazar 2 (linjë ndërlidhëse Kosovë-Serbi).

Roli i Vallaçit është të sigurojë furnizim të rregullt me energji elektrike për palët e kyçura në këtë nënstacion brenda Sistemit të Transmisionit të Kosovës.

Ky nënstacion është i rëndësishëm edhe për shkëmbimin fizik të energjisë elektrike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë përmes linjës ndërlidhëse Vallaç - Novi Pazar.

Në Strategjinë e Energjisë të Qeverisë së Kosovës për periudhën 2022-2031 thuhet se disa nga synimet strategjike të vendit janë forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe funksionimi i tregut të Kosovës.

Aty, po ashtu, thuhet se Kosova është e përkushtuar për zbatimin e të gjitha obligimeve nga Marrëveshja e Komunitetit të Energjisë për të krijuar një treg të lirë, të integruar dhe konkurrues të energjisë elektrike.

Bie indeksi i përgjithshëm i prodhimeve bujqësore

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi për (TM3) 2024.

Ky publikim është i bazuar në grumbullimin e çmimeve të prodhimeve bujqësore vendore në Kosovë.

Grumbullimi i të dhënave është bërë në treg, ferma dhe vende të tjera, ku çmimet e prodhimeve bujqësore mund të grumbullohen.

Në TM3 2024 indeksi i çmimeve të prodhimeve bimore ka rënë për (-9.6 %), krahasuar me

periudhën e njëjtë të vitit 2023.

Indeksi i çmimeve të prodhimeve blegtorale ka rritje për 4,7 %.

Indeksi i përgjithshëm i prodhimeve bujqësore ka rënë për (-6.3 %), krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023.

Prodhimet që krijojnë bazë për indeksin e çmimeve të prodhimeve bujqësore janë ndarë në dy grupe kryesore: prodhimet bimore dhe ato blegtorale. Në kuadër të prodhimeve bimore çmimet janë grumbulluar për këto grupe: drithëra, bimë foragjere, perime,

patate dhe pemë. Në prodhimet blegtorale çmimet janë grumbulluar për blegtorinë dhe prodhimet blegtorale. Në kuadër të blegtorisë, çmimet grumbullohen për katër kategori të kafshëve: gjedhe, dele, derra dhe pula. Këto çmime janë bazuar në peshën e gjallë të kafshëve.

Në kuadër të prodhimeve blegtorale çmimet janë grumbulluar për: qumësht, vezë dhe mjaltë. Të gjitha çmimet janë llogaritur në euro dhe njësitë matëse janë në: kg, litër dhe copë.



Rivaliteti krijoi Renesancën: Armiqësitë e artistëve të mëdhenj

Nga: Alastair SOOKE, kritik
i artit / *The Daily Telegraph*

Në adaptimin e "Disney"-t të veprës Rivalët [Rivals] nga Jilly Cooper, shkrimtarja romantike Lizzie Vereker ulet pranë makinës së saj të shkrimit dhe imagjionon një "botë të pasionit të shfrenuar", të përndjekur nga "bishat që nuk zbuten", të cilat janë të uritura për status dhe seks. "Gjithmonë duhet pasur kujdes", paralajmëron ajo, "të mos të të hanë".

Vereker përshkruan dëshirën për të qenë më e mira, që formëson rrethin e saj të shtresës së lartë në fshat, por ajo mund të përshkruajë po aq mirë edhe venitjen në botën e artit – siç na kujtoi së fundmi Tracey Emin, kur tha se kolegu i saj i dikurshëm në lëvizjen e Artistëve të Rinj Britanikë, Damien Hirst, nuk përfaqësonte më "forcën" (artistët meshkuj, sugjeroi ajo, "arrijnë kulmin në të dyzetat e tyre"). Javën tjetër, një ekspozitë në Akademinë Mbretërore të Arteve do të eksplorojë një tjetër rivalitet, atë që ndodhi në Toskanë në fillim të shekullit XVI, kur u ballafaquan tre gjigantët e Rilindjes Italiane – Leonardo [Leonardo da Vinci], Mikelanxhelo [Michelangelo Buonarroti] dhe Rafaeli [Raffaello Sanzio da Urbino].

Në ditët e sotme, bota e artit minimizon rëndësinë e konkurrencës dhe thekson komunitetin. Koncepti i gjenialitetit artistik ka dalë prej vitësh nga moda; historianët e artit tani vlerësojnë marrëdhëniet familjare dhe shoqërore që kontribuojnë në sukses. Çmimi "Turner" është një shembull i këtij trendi. Në vitin 2015, ai u dha "Assemble"-it, një grupi të gjerë arkitektësh dhe dizajnerësh, dhe jo artistëve. Vitin tjetër, Helen Marten, e cila kritikoi çmimet si "me të meta", premtoi të ndante fitimin prej 25 mijë funtash me kandidatët e tjerë. Në vitin 2019, çmimi u nda mes të katër artistëve të nominuar, të cilët kishin formuar një "kolektiv" të ri. Një tjetër "kolektiv", një grup artistësh dhe aktivistësh nga Irlanda e Veriut me pseudonimin "Array", fitoi çmimin në vitin 2021.

Megjithatë, siç kujton ekspozita e Akademisë Mbretërore, Mikelanxhelo, Leonardo, Rafaeli: Firenze, c. 1504 [Michelangelo, Leonardo, Raphael: Florence, c. 1504], rivaliteti është i rrënjësor në historinë e artit. (E njëjta treshe konkurruese do të jetë gjithashtu subjekt i një dokumentari me tri pjesë në "BBC", Rilindja: Gjak dhe Bukuri / Renaissance: The Blood and the Beauty, ku Charles Dance ka rolin e Mikelanxhelos.) Ekspozita shqyrton një episod të famshëm të artit perëndimor, kur Leonardo dhe Mikelanxhelo u përballën drejtpërdrejt në Firencë, pasi të dy u ngarkuan të krijonin muralet për sallën e këshillit në Pallatin e Sinjorias (tani i njohur si Pallati Vekio), për të përkujtuar fitoret e

Firences.

Leonardo u ftua i pari, në vitin 1503; një vit më vonë, menjëherë pasi kolosi i tij prej mermeri, Davidi, u shfaq para Pallatit Vekio, edhe Mikelanxhelo u ftua të dekoronte të njëjtën dhomë madhështore. Për herë të parë, dy artistët më të shquar të Italisë – me një dallim në moshë prej gati një çereku shekulli (Leonardo lindi më 1452; Mikelanxhelo më 1475) – po punonin (pothuajse) krahas krahas në qytetin ku të dy ishin rritur. Dhe, sipas biografisë të tyre të shekullit XVI, historianit të artit Giorgio Vasari, ata nuk e duronin dot njëri-tjetrin.

Cila ishte arsyeja e përçmimit të madh të ndërsjellë (sdegno grandissimo)? Kanë mbijetuar pak burime parësore që ndriçojnë marrëdhënien e tyre – por, Vasari nuk e nxori këtë urrejtje nga hiçi. Një biografi më e hershme e artistit më të ri tregon se, ndërsa të dy ishin në Firencë, Mikelanxhelo publikisht e talli Leonardon për braktisjen e një monumenti të madh prej bronzi për një sundimtar të Milanos. (Leonardo kishte namin e keq



Studime të kokës së meshkujve, helmetave të ushtarëve dhe të tipareve të fytyrës nga Mikelanxhelo (c. 1504)

për mos përfundimin e projekteve gjatë jetës së tij.) Kemi gjithashtu procesverbalet e një takimi më 25 janar 1504, në të cilin, së bashku me zyrtarë, 30 arkitektë dhe artistë të shquar – përfshirë Botiçelin [Sandro Botticelli] dhe Leonardon – diskutuan se ku duhet të vendosej statuja e Davidit, të cilën Mikelanxhelo e kishte gdhendur nga një bllok i vetëm i mermerit të Kararazit.

Leonardo argumentoi se statuja nuk duhej të vendosej përpara pallatit (ku përfundimisht u vendos), por në një vend më të mbrojtur në Sheshin e Sinjorias (Piazza della Signoria). Arsyeja që dha ishte se atje skulptura e Mikelanxhelos do të mbrohej – por, meqenëse klima e Firences është kaq e butë, është e vështirë të mos mendohet se motivi i tij i vërtetë ishte minimizimi i suksesit të Mikelanxhelos. Ai gjithashtu specifikoi se Davidi duhej të shfaqej con ornamento decente ("me zbulim të përshtatshëm") – një frazë e paqartë që, sipas disa historianëve të artit, i referohej një gjetheje fiku dhe pasqyrore dëshirën e Leonardos për të eklipsuar, madje në mënyrë metaforike për të "kastruar" rivalin e tij më të ri.

Interpretim i tepruar? Ndoshta, thotë Per Rumberg, një nga kuratorët e ekspozitës së



Nudo mashkullore nga Mikelanxhelo (c. 1505-06)

Akademisë Mbretërore. Sidoqoftë, dëshmitë sugjerojnë se marrëdhënia midis këtyre dy burrave ishte komplekse, në rastin më të mirë, dhe në rastin më të keq ishte afër hakmarrjes. Por, kur vjen puna te krijimtaria, çfarë të keqe ka konkurrenca? Analet e historisë së artit janë të mbushura me histori të ngjashme të "miqve armiqtësorë". Një nga historitë bazë të artit perëndimor, rrëfyer nga Plini Plaku, përfshin një garë midis dy artistëve të famshëm grekë të lashtësisë, Zeuksisit dhe Parasiut, për të parë se kush mund të krijonte pikturën më iluzioniste. Natyrat e qeta të Zeuksisit me rrush ishin aq realiste sa që mashtruan zogjtë që kalonin, të cilët zbritën për t'i ngrënë. Megjithatë, kur zbuloi se një perde, të cilën Parasiu e ftoi ta tërhiqte, ishte, në fakt, vepra e kundërshtarit në garë, Zeuksisi pranoi humbjen.

Në Britaninë e shekullit XIX, ishte radha që të ballafaqoheshin JMW Turner dhe John Constable. Ndërsa vendoste një nga peizazhet e tij detare në prag të Ekspozitës Verore të Akademisë Mbretërore më 1832, Turner ndjeu se peizazhi i tij – i realizuar me tone të lehta – rezikonte të eklipsohej nga pamja ngjitur e Urës së Uaterlosë nga Constable, e cila ishte me nuanca të kuqe. Me guximin karakteristik, ai shtoi në kanavacën e tij një njollë të vetme të kuqe që përfaqësonte një bovë. "Ka qenë këtu", deklaroi Constable, kur vuri re shtesën e Turnerit, "dhe qëlloi me armë."

Një marrëdhënie tjetër e tensionuar – këtë herë midis dy modernistëve francezë të shekullit XIX – ishte tema e një



Beteja e Kashinës nga Bastiano da Sangallo, sipas Mikelanxhelos (c. 1542)

ekspozite të shkëlqyer në Muzeun Metropolitan të Artit në Nju-Jork në vitin e kaluar. Në fund të viteve '60 të shekullit XIX, disa vite pasi ishin takuar për herë të parë në Luvër, Edgar Degas pikturoi mikun e tij të sjellshëm dhe me mjekër, Edouard Manet, të mbështetur në një divan ndërsa dëgjonte gruan e tij, Suzanne, që luante në piano.

Një skenë e këndshme, apo jo? Por, kur Degas ia dhuroi këtë portret të dyfishtë Manetit, ky i fundit – ndoshta i nervozuar nga paraqitja e tipareve të bashkëshortes së tij – shqeu kanavacën. "U largova pa thënë mirupafshim", i tha Degas tregtarit Ambroise Vollard, "duke marrë me vete pikturën time".

Të paktën, Manet vetëm e grisi një pikturë. Kur Vincent van Gogh dhe Paul Gauguin jetuan së bashku në atë që njihet si "Shtëpia e Verdhe" në Arle, në jug të Francës, gjërat u bënë aq të tensionuara sa që, pak para Krishtlindjes së vitit 1888, holandezi kërcënoi ish-tregtarin francez të bursës, përpara se ai të priste veshin e tij me një brisk. Gjithsesi, zënka mes Manetit dhe Degasit u zbut ("Si mund të mbetet njeriu në marrëdhënie të këqija me Manetin", ka thënë Degas), ndryshe nga armiqtësia mes piktorëve britanikë të shekullit XX, Francis Bacon dhe



Punim i Rafaelit, sipas Davidit të Mikelanxhelos (c 1505-08)

Lucian Freud, të cilët ishin të pandarë në Londër pas Luftës së Dytë Botërore. Sipas gruas së dytë të Freudit, Caroline Blackwood, Baconi i vizitonte ata "pothuajse çdo natë gjatë gjithë martesës sime me Lucianin. Ne gjithashtu hanim drekë së bashku". Megjithatë, në vitet '80 të shekullit XX, Freud përçmonte pikturat e Baconit si "të tmerrshme" dhe, për ta bezdisur, refuzonte gjithmonë të huazonte ndonjë pikturë të rëndësishme të Baconit që ai kishte në zotërim. E quajtur Dy figura [The Buggers], ajo shfaqte dy burra në një përplasje mbi çarçafë të rrudhur dhe qëndronte në dhomën e tij të gjumit.

Ndonjëherë, rivalitetet artistike

nuk janë thjesht pasqyrim i "maskulinitetit toksik". Ato mund të frymëzojnë rezultate të shkëlqyera krijuese. Shikoni Henri Matisen dhe Pablo Picason, i cili ishte më shumë se një dekadë më i ri. Karakteret e tyre ishin shumë të ndryshme (Matisse ishte i qetë, Picasso ishte magnetik) dhe ka shumë tregime për përplasjet e tyre. Në fillimet e marrëdhënies së tyre, miqtë e Picassos përdornin shigjetat e lojës për të qëlluar një pikturë të Matises të cilën ky i





Detaj nga punimi i Leonardos Shën Ana, Virgjëresha, Fëmijë Jezus dhe Shën Gjon Pagëzori si foshnje (rreth viteve 1506-08)

fundit ia kishte dhuruar atij. Megjithatë, gjatë jetës së tyre, ata i kushtuan vëmendje të madhe punës së njëri-tjetrit, e cila shpesh nxiste përparime në krijimtarinë e tyre. Pasi Matisse vdiq në vitin 1954, Picasso ndjeu mungesën e partnerit të tij të mëparshëm me të cilin kishte përplasje. Historiani i artit, Jack Flam, i krahason ata me "atletë të nivelit të lartë që caktojnë ritmin e njëri-tjetrit". Të dy arritën lartësi estetike më të mëdha sesa ato që do të kishin përmbushur po të ishin, si të thuash, duke u ngjitur vetëm në mal. A është e tepruar të shihet rivaliteti si një formë tjetër e bashkëpunimit?

Sigurisht, në Firencë të fillimit të shekullit XVI, Leonardo – tashmë në të pesëdhjetat kur nisi të planifikonte muralin e tij, Beteja e Angiarit – nuk ndryshoi shumë pas kontaktit me veprën e Mikelanxhelos. Por, është e mundur që Mikelanxhelo të ketë përshtatur qasjen e tij pasi mësoi për punën e Leonardos. Skena e betejës së Leonardos ishte një përshkrim i trazuar, i mbushur me dhunë dhe emocion të skajshëm. Në kontrast, Mikelanxhelo zgjodhi të paraqiste një moment përpara fillimit të betejës, ku ushtarët që po laheshin – një temë që i jepte mundësi të shfaqte një nga motivet e tij të preferuara: nudot e idealizuara mashkullore – thirreshin për të kapur armët.

Megjithëse të dy prodhuan vizatime përgatitore, asnjë mural nuk u përfundua, pasi këta artistë të kërkuar u thirrën gjetkë. Në fund, ishte personazhi i tretë në shfaqjen e Akademisë Mbretërore – Rafaeli – i cili, pasi erdhi në Firencë për të mësuar nga bashkëmoshatarët e tij më të mëdhenj, në Romë përfundoi si antagonist kryesor i Mikelanxhelos. Il Divino ("i hyjnueshmi"), siç quhej toskani i heshtur, madje akuzoi fillestarin nga Urbinoja për plagjiaturë. Kjo është ajo gjëja me ata "bishat që nuk zbuten": ato kurrë nuk ndryshojnë njollat e tyre. /Telegrafi/



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Futbollisti Mërgim Pefqeli 'Ylli i Javës'

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Federata e Futbollit të Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin "Ylli i Javës". Ky çmim për javën e 12-të në Albi Mall Superligë i është dhënë futbollistit të KF Dukagjini, Mërgim Pefqeli.

Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga Komisioni i

Veteranëve të Futbollit, i përbërë nga Vllaznim Visoka, Muhamet Sylejmani dhe Emin Sekiraqa. Ky komision vendosi që çmimi "Ylli i Javës" për xhiron e 12-të t'i takojë Mërgim Pefqelit, i cili, përveç që shënoi golin e epërsisë, dha shumë kontribut për skuadrën e tij, KF Dukagjini, në ndeshjen në transfertë kundër Gjilanit, të

cilën e fitoi me rezultat 1:2. Pasi mori këtë çmim, Pefqeli u shpreh i lumtur që u vlerësua më i miri i javës: "Kemi pasur një ecuri të mirë në katër ndeshjet e fundit. Ka qenë një punë e stafit teknik që në këto katër ndeshje t'i fitojmë pikët. Ka qenë çdo lojtar, në çdo repart shumë kompakt. Në fillim të kampionatit kemi

pasur shumë prurje, dhe me punën e stafit dhe punën e trajnerit Ismet Munishi, kemi arritur të komponohemi shumë mirë. Tashmë jemi më afër daljes në Evropë, me shumë pikë sesa zonat e rrezikshme, dhe shpresoj që do të vazhdojmë performancën e tillë. Falënderoj shokët e skuadrës, stafin, në veçanti



kryetrajnerin Munishi, sepse pa ta nuk do të shpallesha më i miri i xhiros", tha Pefqeli për faqen zyrtare të FFK-së.

Konferenca për Sportin: Ka nevojë për më shumë punë që të parandalohen fenomenet negative në aktivitetet sportive

ATHINË, 5 NËNTOR - Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, në Athinë të Greqisë, më 4 dhe 5 nëntor, ka organizuar Konferencën për Promovimin e Sigurisë, Integritetit, Barazisë dhe Përfshirjes në Sport.

Për dy ditë radhas në këtë konferencë diskutimet u përqendruan në disa nga temat dhe çështjet kritike me të cilat përballlet bota e sportit dhe sportistëve, publiku dhe shoqëritë tona, si: siguria dhe integriteti në sport, barazia dhe përfshirja, dinjiteti dhe mirëqenien e sportistëve. Që të gjithë folësit theksuan se ka përparime në këtë aspekt, por ende ka nevojë për më shumë punë që të parandalohen fenomenet negative në aktivitetet sportive, por theksuan nevojën që secili ta japë kontributin e vet.

Në këtë konferencë morën pjesë parlamentarë, politikëbërës, atletë, organizata sportive dhe ekspertë nga fusha të ndryshme,

të cilët eksploran dimensionet e shumanshme të këtyre çështjeve brenda fushës së sportit.

Hapjen e kësaj konference me fjalë rasti e bëjnë presidenti i Parlamentit të Greqisë, Constantine An. Tassoulas, vendi i të cilit ishte edhe nikoqiri i kësaj konference, si dhe presidenti i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Theodoros Rousopoulos, të cilët theksuan se institucionet e tyre njohin potencialin transformues të sportit si një mjet i fuqishëm për përparimin shoqëror dhe për ruajtjen e vlerave thelbësore në të gjitha vendet.

Kuvendin e Kosovës në këtë konferencë e përfaqësuan deputetët Enis Kervan, kryetar i Grupit Parlamentar Multietnik, njëherësh anëtar i Delegacionit të Kuvendit të Kosovës në APKE, si dhe Ardian Gola, kryetar i Komisionit Parlamentar për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe



Sport.

Krahas folësve të tjerë, për këto tema të pranishmëve iu drejtua edhe deputeti Kervan, i cili, pasi i njoftoi të pranishmit se Kosova do të jetë organizatore e Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030, përderisa nga përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare sportive kërkoi këshilla se çfarë duhet pasur parasysh gjatë organizimit të këtij aktiviteti. "Fillimisht dëshiroj ta shpreh

kënaqësinë time që jam pjesëmarrës në këtë konferencë në të cilën diskutohet për sportin. Dëshiroj t'i falënderoj penalistët për informatat dhe prezantimet e tyre shumë përmbajtësore, por edhe kam një pyetje në përgjithësi, Lojërat Mesdhetare Prishtina 2023 do të mbahen në Kosovë, andaj çfarë mendoni dhe rekomandoni se duhet t'i kushtojmë më shumë vëmendje gjatë organizimit të

këtyre garave", shtoi deputeti Kervan.

Në pyetjen e Kervanit u përgjigj përfaqësuesja e Këshillit të Lartë të Atletikës Botërore, Catherine Pitre, e cila tha se organizimi i garave të kësaj natyre kërkon përgatitje me kohë, koordinim gjithëpërfshirës të shtetit me organizatat relevante ndërkombëtare, me theks të veçantë marrja e masave të sigurisë, logjistikës, akomodimit, plane eventuale të evakuimit, si dhe masat e tjera të nevojshme që sigurojnë mbarëvajtjen pa probleme të tyre.

Po ashtu, në fund të konferencës u themelua Aleanca Parlamentare për Qeverisje dhe Integritet në Sport, e cila ka për qëllim forcimin dhe bashkëpunimin me forcat parlamentare dhe nxitjen e iniciativave të përbashkëta parlamentare.

Gjatë kësaj konference Parlamenti i Greqisë ndau edhe medalje për kampionët paraolimpikë dhe olimpikë të cilët përfaqësuan Greqinë.

I pafat Neymari, dëmtimet e "ndjekin" nga pas sulmuesin brazilian

RIAD, 5 NËNTOR - Sulmuesi brazilian Neymar Jr ka thyer heshtjen e tij pasi u detyrua të largohet nga lëndimi në paraqitjen e tij të fundit për Al-Hilal. Brazili bënë paraqitjen e tij të dytë si zëvendësues për Al-Hilal të hënën, pas më shumë se një viti i lënduar me ligamentin ACL që pësoi gjatë detyrës ndërkombëtare në vitin 2023.

Sulmuesi 32-vjeçar, i cili iu bashkua skuadrës saudite sezonin e kaluar në një

marrëveshje që i jep atij 378 000 funte në ditë, është kufizuar në vetëm shtatë paraqitje për klubin e tij të ri.

Neymari bëri rikthimin e tij të shumëpritur në tetor kur hyri në fushë për 15 minutat e fundit të ndeshjes së Al-Hilalit në Ligën e Kampionëve të Azisë me Al Ain. Pavarësisht prej 369 ditëve jashtë fushave, Neymari dukej si në shtëpi dhe një përmbledhje e rikthimit të tij mbresëlënës shpejt u bë virale. Megjithatë, problemet



e dëmtimit të ish-yllit të PSG-së duket se do të vazhdojnë pasi ai u tërhoq në paraqitjen e tij të dytë, pavarësisht se hyri vetëm si

zëvendësues.

Neymar u fut në lojë në minutën e 58, por mundi të luante vetëm 29 minuta para se Jorge Jesus të detyrohej ta tërhojë brazilianin me një dëmtim të dyshuar të kofshës. Shpejt u shfaqën pamjet e brazilianit duke hedhur këpucët e tij, ndërsa dukej i shkatërruar nga ngjarjet që po shpalosen pas një magjie kaq të gjatë jashtë fushe.

Nuk ka vonuar shumë dhe Neymari ka ofruar një përditësim

që mund t'u japë tifozëve shpresë për një shërim të shpejtë. "Lojë e mrekullueshme nga ekipi, shumë i lumtur që jam kthyer duke luajtur në shtëpi dhe falemindër për dashurinë nga tifozët!" "Tani është koha për t'u rikuperuar. Mbetemi të vendosur dhe të fortë", ka shkruar Neymar në "Instagram".

Bazuar në këtë përgjigje, dikush do të supozonte se braziliani nuk është shumë i shqetësuar për pengesën e tij të fundit.

Mbahet tryeza e 6 e sportit, koordinohen punët për zbatimin e reformës që sjell ligji i ri i sportit

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Zëvendësministria e Sportit, Daulina Osmani, ka thënë se tryeza e gjashtë e sportit po shërben si platformë për

bashkërendim ndërinstitucional së bashku me strukturat sportive për zbatimin e reformës që e sjell ligji i ri i sportit.

Zëvendësministria Osmani gjatë fjalës së saj ka theksuar se kjo është reforma më e thellë ligjore e sektorit të sportit e cila, përveç që adreson nevojat

e komunitetit sportiv, njëherësh edhe mundëson zhvillimin efektiv, të qëndrueshëm dhe transparent të sportit në vend.





Nr. 1925/24

Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, lidhur me nenin 7 të Udhëzimit Administrativ MFPT - Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, dhe nenit 8 par. 4, nenit 11, nenit 21 nën par. 2.2 dhe nenit 25 të Rregullores Nr. 55/21 për Marrëdhënien e Punës të N.P.L "Përparimi" Sh. A. në Vushtrri e miratuar me datë 21.12.2021 nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L "Përparimi" Sh. A., e duke u bazuar në vendimin me nr. të protokollit **1924/24** të datës **04.11.2024** të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L "Përparimi" Sh. A, me datë **04.11.2024** shpall:

KONKURS PUBLIK

I. Titulli: Bagerist

Numri i ekzekutuesve: 1

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.

Përgatitja profesionale: Shkolla e mesme profesionale

Përvoja e punës: Një (1) vit në punë profesionale përvojë me ekskavator;

I raporton: Udhëheqësit të Njesisë së Logjistikës

Koeficienti i pagës: 504.18 Euro Bruto

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Operon me ekskavator dhe me mjete të tjera të rënda në mënyrë të sigurt për punët e gërmimit, ngarkimit, transportit, mbylljen dhe hapjen, mbylljen e kanaleve, varrezave, gropave etj.
- Bën mirëmbajtjen e rregullt ditore dhe kontrollet e sigurisë së ekskavatorit.
- Mban përgjegjësi për materialin e shpenzuar, si dhe shpenzimet e materialit i shënon në dëshmitë përkatëse sipas dokumentacionit të ndërmarrjes.
- Kujdeset për mirëmbajtjen e ekskavatorit, larjen, lysterjen, evidentimin e prishjeve etj.
- Paraqet qdo defekt dhe dëmtim të shkaktuar në ekskavator, si dhe bën arsyetimin e shpenzimeve të derivateve.
- Për punën e tij i përgjigjet Udhëheqësit të Njesisë së Logjistikës.

Kusht i posaçëm:

- Kategoria C e vozitjes.
- Aftësi për t'u përshtatur me kushte të punës.

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L "Përparimi" Sh. A - Vushtrri.;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar);
- Ekstraktin e lindjes; (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Dëshmia se ka patentën e shoferit të kategorisë C (e skanuar);
- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohen);
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara) (nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit (e skanuar);

II. Titulli: Arkëtar

Numri i ekzekutuesve: 1

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.

Përgatitja profesionale: Shkolla e mesme apo përgatitje universitare

Përvoja e punës: Preferohet një (1) vit

I raporton: Zyrtares Kryesore Financiare

Koeficienti i pagës: 442.56 Euro Bruto

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Pranon pagesat në të gatshme dhe plotëson fletëpagesën në tri kopje, kopjen e parë ia dorëzon palës.
- Udhëheqë ditarin e arkës veçmas për karburante.
- Të hyrat e gatshme i dorëzon në bankë - në llogarinë e ndërmarrjes, pa vonesë.
- Përpilon ditarin e arkës për çdo ditë mbi të hyrat dhe ia bashkëngjijt dokumentacionin në gjendje të rregullt, i verifikuar nga personat e autorizuar.
- Çdo pagesë në favor apo barrë në të gatshme e evidenton në urdhëresat "inkasoni-paguani".
- Është i obliguar që t'i përmbahet maksimumit të mjeteve financiare të arkës për të cilin ka vendim organi kompetent.
- Çdo ditë i raporton Përgjegjësit financiar të shërbimit për gjendjen në arkë.
- Mban përgjegjësi për pagesën e dokumenteve të cilat nuk janë të vërtetuara nga personat e autorizuar, që janë në kundërshtim me ligjin.

- Kryen edhe punë tjera me urdhëresë të Zyrtares Kryesore Financiare.
- Për punën e vetë i përgjigjet drejtpërdrejt Zyrtares Kryesore Financiare.

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L "Përparimi" Sh. A - Vushtrri.;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar);
- Ekstraktin e lindjes; (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohen);
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara) (nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit (e skanuar);

➤ Kriteret e përgjithshme që duhet t'i plotësojnë të gjithë kandidatët.

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë veprimi.
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me Ligjin për Gjuhët.

➤ Mënyra e vlerësimit të kandidatëve.

- Testimi me shkrim deri në shtatëdhjetë (70) pikë.
- Intervista me gojë deri në njëzetë (20) pikë
- Jetë përshkrimi (CV) i kandidatit deri në dhjetë (10) pikë.

➤ Periudha e aplikimit të kandidatëve dhe kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të të njëjtit. Shpallja është e hapur nga data **05.11.2024** deri me datë **19.11.2024** në ora 16:00.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

- Verifikimi paraprak i aplikacioneve të kandidatëve më së largu deri me datë **15.11.2024**.
- Afati për ankesë nga data **18.11.2024** deri me datë **20.11.2024**.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen testit me shkrim, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë **02.12.2024**.
- Afati për ankesë nga data **03.12.2024** deri me datë **05.12.2024**.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen intervistës me gojë, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë **19.12.2024**.
- Afati për ankesë nga data **20.12.2024** deri me datë **23.12.2024**.
- Publikimi i rezultateve përfundimtare në lidhje me kandidatin e suksesshëm është më së largu **28.12.2024**.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo, dhe varësisht nga puna e komisionit vlerësues, dhe departamentit të personelit. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë në çdo fazë të procedurës së rekrutimit, ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njëjta të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

➤ Mënyra e aplikimit dhe komunikimi me kandidatët

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në Zyrën e Arkivës të N.P.L "Përparimi" Sh. A në qytetin e Vushtrrisë, rr. "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" nr. 82, (ish objekti i TMK-së afër Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega në Vushtrri) çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00. Departamenti i Personelit duke zbatuar nenin 8 par. 3 të Udhëzimit MFPT-Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, do tu ofrojë sqarime të nevojshme për kandidatët në lidhje me kriteret e konkursit publik, dhe do tu asistoj dhe tu jap udhëzimet e nevojshme për aplikim me anë të adresës elektronike.

Dorëzimi i aplikacionit me gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: hrperparimi@gmail.com.

I gjithë komunikimi gjatë procedurave të konkursit publik do të zhvillohet nëpërmjet komunikimit elektronik, dhe secili nga kandidatët do të njoftohet individualisht.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.

➤ Sqarim

Ndërmarrja ka për qëllim të sqarojë çështjen e termeve të përdorura në aspektin gjinor, meqë rast fjalët dhe titujt e një gjinie përfshijnë edhe gjininë tjetër.

➤ Përfundim

N.P.L "Përparimi" Sh. A në Vushtrri ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, dhe inkurajohen komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuara, dhe gjinia më pak e përfaqësuar që të aplikojnë.



Br. 1925/24

U prilog članu 8, članu 10 pod st. 2.2 i člana 15 Zakona br. 03/L-212 o radu objavljen u Službenom listu Republike Kosovo 01.12.2010, u vezi sa članom 7 Administrativnog uputstva MFPT - br. 01/2024 za regulisanje tenderskih procedura u javnom sektoru, koji je deo Zakona br. 03/L-212 o radu koji je objavljen u Službenom listu Republike Kosovo dana 31.10.2017. godine, i član 8. st. 4, član 11, član 21 pod st. 2.2 i član 25 Uredbe br. 55/21 o radnim odnosima NPL "Përparimi" Sh. A. u Vuçitru odobreno 21.12.2021 od strane Borda direktora NPL "Përparimi" Sh. A., a na osnovu rješenja br. Protokola 1924/24 od 04.11.2024, godine glavnog izvršnog direktora, NPL "Përparimi" Sh. A. od 04.11.2024. godine objavljuje:

JAVNI KONKURS

I. Naslov: Bager

Broj izvršilaca: 1

Radno vrijeme: 40 sati sedmično

Trajanje termina: Na određeno vreme od jedne (1) godine, od čega će šest (6) meseci biti probni rad, sa mogućnošću produženja.

Stručna priprema: Srednja stručna škola

radno iskustvo: Jedna (1) godina profesionalnog radnog iskustva na bageru;

Izveštava za: Vođe logističkih jedinica

Koeficijent plate: 504.18 Euro Bruto

Opis radnih zadataka i odgovornosti:

- Bezbjedno upravlja bagerima i drugom teškom opremom za kopanje, utovar, transport, zatvaranje i otvaranje, zatvaranje kanala, groblja, jama itd.
- Obavlja redovno svakodnevno održavanje i sigurnosne provjere bagera.
- Preuzima odgovornost za utrošeni materijal, kao i materijalne troškove evidentira u relevantnim evidencijama prema dokumentaciji kompanije.
- Održavanje bagera, pranje, farbanje, otkrivanje oštećenja itd.
- Predstavlja sve nedostatke i oštećenja nastalu na bageru, kao i opravdavanje troškova derivata.
- Za svoj rad odgovara načelniku Jedinice za logistiku.

Poseban uvjet:

- Vozačka kategorija C.
- Sposobnost prilagođavanja uslovima rada.

Uz prijavu je potrebno priložiti sljedeće:

- Prijavni obrazac za NPL "Përparimi" Sh. A - Vuçitri;
- Potvrde o školskoj spremi (skenirane);
- Ekstrakt rođenja; (sertifikat izdat online na platformi e-Kosova će biti prihvaćen);
- Dokaz o posjedovanju vozačke dozvole C kategorije (skenirano);
- Potvrda o krivičnoj osudi koju je izdao Sudski savet Kosova, da nema krivičnih osuda u centralnoj krivičnoj evidenciji Republike Kosovo (uverenje izdato online na platformi e-Kosova će biti prihvaćeno);
- Dokaz o radnom iskustvu (skenirano) (nije obavezno);
- Kopija lične karte (skenirana);

II. Naslov: Blagajnik

Broj izvršilaca: 1

Radno vrijeme: 40 sati sedmično

Trajanje termina: Na određeno vreme od jedne (1) godine, od čega će šest (6) meseci biti probni rad, sa mogućnošću produženja.

Stručna priprema: Srednja škola ili univerzitetsko obrazovanje

Radno iskustvo: Poželjno jedna (1) godina

Izveštava za: Glavnoj službenici za finansije

Koeficijent plate: 442.56 Euro Bruto

Opis radnih zadataka i odgovornosti:

- Prima gotovinske uplate i popunjava uplatnicu u tri primerka, pri čemu prvi primerak daje stranci.
- Vodi blagajnički dnevnik posebno za gorivo.
- Gotovinske prihode predaje u banci - na račun preduzeća, bez odlaganja.
- Svakodnevno sastavlja blagajnički dnevnik o prihodima i rashodima, te prilaže dokumentaciju u urednom stanju, overenu od strane ovlašćenih lica.
- Svaku uplatu ili isplatu u gotovini evidentira na nalozima "naplati-izdvajaj".
- Obavezan je da se pridržava maksimalnog iznosa gotovinskih sredstava u blagajni, za što je nadležno telo donelo odluku.
- Svakodnevno izveštava finansijskog rukovodioca službe o stanju u blagajni.
- Odgovara za plaćanje dokumenata koja nisu overena od strane ovlašćenih lica i koja su u suprotnosti sa zakonom.
- Obavlja i druge poslove po nalogu Glavne službenice za finansije.
- Za svoj rad odgovara direktno Glavnoj službenici za finansije.

Uz prijavu je potrebno priložiti sljedeće:

- Prijavni obrazac za N.P.L "Përparimi" Sh. A - Vuçitri;
- Potvrde o školskoj spremi (skenirane);
- Ekstrakt rođenja; (sertifikat izdat online na platformi e-Kosova će biti prihvaćen);
- Potvrda o krivičnoj osudi koju je izdao Sudski savet Kosova, da nema krivičnih osuda u centralnoj krivičnoj evidenciji Republike Kosovo (uverenje izdato online na platformi e-Kosova će biti prihvaćeno);
- Dokaz o radnom iskustvu (skenirano) (nije obavezno);
- Kopija lične karte (skenirana);

➤ Opšti kriterijumi koje svi kandidati moraju ispuniti.

- Budite državljanin Republike Kosovo.
- Imaju puni kapacitet za djelovanje.
- Da vlada najmanje jednim od službenih jezika u skladu sa Zakonom o jezicima.

➤ Način vrednovanja kandidata.

- Pismeni test do sedamdeset (70) bodova.
- Usmeni intervju do dvadeset (20) bodova
- CV kandidata do deset (10) bodova.

➤ Rok za prijavu kandidata i okvirni kalendar procedure zapošljavanja.

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) kalendarskih dana od dana objavljivanja. Oglas je otvoren od 05.11.2024 do 19.11.2024 u 16:00 sati.

Okvirni kalendar procedure zapošljavanja:

- Prethodna verifikacija prijava kandidata najkasnije do 15.11.2024.
- Rok za žalbu je od 18.11.2024. do 20.11.2024.
- Period kada će kandidati polagati pismeni test, i kada će biti obavljena njihova evaluacija, biće najkasnije do 02.12.2024.
- Rok za žalbu je od 03.12.2024. do 05.12.2024.
- Period kada će kandidati obaviti usmeni intervju i kada će biti obavljena njihova evaluacija biće najkasnije do 19.12.2024.
- Rok za žalbu je od 20.12.2024. do 23.12.2024.
- Objavljivanje konačnih rezultata za uspješnog kandidata najkasnije do 28.12.2024.

Okvirni kalendar postupka zapošljavanja može biti duži ili kraći, u zavisnosti od toga da li je pritužba podneta ili ne, a u zavisnosti od rada komisije za evaluaciju i kadrovske službe.

U svim slučajevima kada se žalba podnese u bilo kojoj fazi postupka zapošljavanja, pritužba će imati suspenzivno dejstvo, sve dok istu ne razmotri Komisija za žalbe.

➤ Kako se prijaviti i komunicirati sa kandidatima

Zainteresovani kandidati prijavni formular mogu dobiti u Arhivu NPL "Përparimi" Sh. A u gradu Vuçitru, ul. "Gjergj Kastriot Skënderbeu" br. 82, (bivša zgrada TMK kod Osnovnog suda u Mitrovici – ogranak u Vuçitru) svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Kadrovska služba za sprovođenje člana 8 st. 3 Uputstva MFPT-br. 01/2024 za Uređenje konkursnih procedura u javnom sektoru, daće potrebna pojašnjenja za kandidate u vezi sa kriterijumima javnog konkursa, te pomoći i dati potrebna uputstva za prijavu putem elektronske adrese.

Podnošenje prijave sa svom dokumentacijom traženom u ovom javnom oglasu vrši se isključivo putem elektronske adrese i to: hrperparimi@gmail.com.

Sva komunikacija u toku postupka javnog nadmetanja odvijaće se putem elektronske komunikacije, a svaki od kandidata će biti pojedinačno obaviješten.

Napomena: Prijave dostavljene nakon navedenog roka neće biti prihvaćene.

➤ Po jasnjenje

Preduzeće ima za cilj da pojasni upotrebu rodno obeleženih termina, pri čemu reči i titule jednog roda obuhvataju i drugi rod.

➤ ZAKLJUČAK

NPL "Përparimi" Sh. A u Vuçitru nudi jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Republike Kosovo, a nevećinske zajednice i njihovi pripadnici, osobe sa invaliditetom i nedovoljno zastupljeni pol se podstiču da se prijave.

NJOFTIM


Njoftojmë të gjithë klientët se “Jeta Roka B.I” ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr.b. 811143619 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Jeta Roka B.I”, donelo odluku o prestani rada sa nr.b. 811143619 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Jeta Roka B.I” has come to the decision to quit its business: 811143619 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook 

www.facebook.com/gjejpuneshejte

RESTAURANT



SWISS

TAVERNA



Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Euroлона & Feha Sh.p.k. me nr. Unik Identifikues: 810711889 ka marr vendim për uljen e kapitalit të biznesit nga 630,000.00€ bëhet në 26,097.56€.

- Shqiprim Neziri nga Junik shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit “Kuvendi i Junikut” Junik.

- Gentiana Spahija nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e maturës të Gjimanzit “Hjadar Dushi” Gjakovë.

- Anita Stuja nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit, dëftesat e kl. 10.11.12 dhe certifikatën e maturës të Gjmnazit “Hjadar Dushi” Gjakovë.

- Faton Kastrati Vermicë, K.K Malishevë shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3. dhe diplomën e sh.m.t. “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.

- Shqipe Goranci nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.e. “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Haxhi Ukshini nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.m. “Hysni Zajmi” Gjakovë.


- Kushtrim Halili, shpall të pavlefshme dëftesat e sh.m.l.e. “Hasan Prishtina”.

- Për informata më të hollëshme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.



044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



TRADITË QË NGA

1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

